

Shkruan:
Milazim
KRASNIQI



MASAT NDËSHKUESE TË BE-së, OPOZITA: KOHA E FUNDIT PËR NJË RRUGË TË RE PA KURTIN



FAQE 4-5

Partitë opozitare, PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, kanë reaguar ndaj masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian për Kosovën. Sipas opozitës, Kosova është në një pozicion të keq ndërkombëtarisht. Masat ndëshkuese përfshijnë:

suspendimin e përkohshëm të punës së trupave të krijuara në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, mosftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë dhe suspendimin e vizitave bilaterale dhe ndaljen e programimit të fondeve për

Kosovën nga IPA 2024. Javën që lamë pas Kosova nuk u përfshi në Programin e Evropës Digjitale të financuar nga BE-ja në vlerë prej 7.5 miliardë eurosh, ndërkaq Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi u përfshinë në këtë program

DEKLARATA KUSHTETUESE E 2 KORRIKUT SHËNON PIKËNISJEN E SHTETËSISË SË KOSOVËS

FAQE 3



TË SHTËNA MASIVE NË SHBA: DY TË VRARË, 28 TË PLAGOSUR, TRE NË GJENDJE KRITIKE



AKTUALE



VAZHDOJNË TRAZIRAT NË FRANCË


F. 2

BILL KLINTONI TË HËNËN NË TIRANË

F. 5



EKONOMI



PAGAT NË KOSOVË, MË PAK SE 140 EURO RITJE PËR NJË DEKADË

F. 7

ME POSTË E TIKTOK, PARATË FALSE VËRSHOJNË NË TREG

F. 6

BLETARËT NË HALL ME MOTIN

F. 7

SPORT



'DARDANËT' VAZHDOJNË PËRGATITJET PËR 'EUROBASKET 2025'

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Të shtëna masive në ShBA: Dy të vrarë, 28 të plagosur, tre në gjendje kritike

BALTIMORE, 2 KORRIK - Dy persona u vranë dhe 28 të tjerë u plagosën në një sulm masiv me armë në Baltimore të ShBA-së, njoftuan autoritetet policore. Të gjithë viktimat ishin të rritur. Agjencia e lajmeve AP raporton se tre persona janë në gjendje kritike pas sulmit të bërë në mëngjesin e 2 korrikut. Komisionari në detyrë i Departamentit të Policisë në Baltimore, Richard Worley, konfirmoi numrin e të vdekurve dhe të plagosurve në një konferencë për medie në vendin e ngjarjes. Një 18-vjeçare dhe një 20-vjeçar janë gjetur të vdekur në vendin ku u krye sulmi, raporton AFP, duke cituar një deklaratë të policisë. Dhjetë persona u dërguan në spitale nga policia dhe 19 të tjerë shkuan vetë, raportoi Fox 45,

duke shtuar se një dëshmitar tha se dëgjoji 20 deri në 30 të shtëna me armë. Të shtënat ndodhën rreth 12:30 të mëngjesit, sipas kohës lokale, në një festë në zonën e Brooklyn Homes të Baltimores Jugore, tha Worley. "Dua që ata që janë përgjegjës të më dëgjojnë dhe të më dëgjojnë shumë qartë", tha kryetari i Baltimore, Brandon Scott. "Ne nuk do të ndalemi derisa t'ju gjejmë dhe do t'ju gjejmë. Deri atëherë, shpresoj që çdo frymë që merrni, të mendoni për jetët që keni marrë". Siç raporton AP, autoritetet bënë me dije se ende nuk ka të arrestuar për këto të shtëna. Scott i kërkoi kujtdo që ka informacion t'i ndihmojë hetuesit të gjejnë "frikacakët" që ishin përgjegjës për të shtënat. Arkivi i Dhunës me Armë (GVA) përkufizon "të shtënat masive" si




një incident me armë, në të cilin katër ose më shumë njerëz janë plagosur ose vrarë. Me më shumë armë zjarri sesa banorë, në ShBA është raportuar për të paktën 44 357 të vrarë nga

armët e zjarrit në vitin 2022, përfshirë 24 090 vetëvrasje, sipas GVA-së. Sipas FBI-së, në ShBA ka pasur 345 incidente të tilla në periudhën 2000-2020, të cilat kanë rezultuar me mbi 1 000

njerëz të vrarë dhe mbi 1 800 të plagosur. Sulmi më vdekjeprurës i tillë - në Las Vegas në vitin 2017 - ka lënë më shumë se 50 njerëz të vrarë dhe mbi 500 të plagosur.

Të shtëna masive në ShBA: Dy të vrarë, 28 të plagosur, tre në gjendje kritike

BALTIMORE, 2 KORRIK - Dy persona u vranë dhe 28 të tjerë u plagosën në një sulm masiv me armë në Baltimore të ShBA-së, njoftuan autoritetet policore. Të gjithë viktimat ishin të rritur. Agjencia e lajmeve AP raporton se tre persona janë në gjendje kritike pas sulmit të bërë në mëngjesin e 2 korrikut. Komisionari në detyrë i Departamentit të Policisë në Baltimore, Richard Worley, konfirmoi numrin e të vdekurve dhe të plagosurve në një konferencë për medie në vendin e ngjarjes. Një 18-vjeçare dhe një 20-vjeçar janë gjetur të vdekur në vendin ku u krye sulmi, raporton AFP, duke cituar një deklaratë të policisë. Dhjetë persona u dërguan në spitale nga policia dhe 19 të tjerë shkuan vetë, raportoi Fox 45, duke shtuar se një dëshmitar tha se dëgjoji 20 deri në 30 të shtëna me armë.



Të shtënat ndodhën rreth 12:30 të mëngjesit, sipas kohës lokale, në një festë në zonën e Brooklyn Homes të Baltimores Jugore, tha

Worley. "Dua që ata që janë përgjegjës të më dëgjojnë dhe të më dëgjojnë shumë qartë", tha kryetari i Baltimore, Brandon

Scott. "Ne nuk do të ndalemi derisa t'ju gjejmë dhe do t'ju gjejmë. Deri atëherë, shpresoj që çdo frymë që merrni, të mendoni për jetët që

keni marrë". Siç raporton AP, autoritetet bënë me dije se ende nuk ka të arrestuar për këto të shtëna. Scott i kërkoi kujtdo që ka informacion t'i ndihmojë hetuesit të gjejnë "frikacakët" që ishin përgjegjës për të shtënat. Arkivi i Dhunës me Armë (GVA) përkufizon "të shtënat masive" si një incident me armë, në të cilin katër ose më shumë njerëz janë plagosur ose vrarë. Me më shumë armë zjarri sesa banorë, në ShBA është raportuar për të paktën 44 357 të vrarë nga armët e zjarrit në vitin 2022, përfshirë 24 090 vetëvrasje, sipas GVA-së. Sipas FBI-së, në ShBA ka pasur 345 incidente të tilla në periudhën 2000-2020, të cilat kanë rezultuar me mbi 1 000 njerëz të vrarë dhe mbi 1 800 të plagosur. Sulmi më vdekjeprurës i tillë - në Las Vegas në vitin 2017 - ka lënë më shumë se 50 njerëz të vrarë dhe mbi 500 të plagosur.

Kompania Shell vazhdon tregtimin e gazit rus, edhe pse u zotua se s'do ta bënte

LONDËR, 2 KORRIK - Kompania e energjisë Shell po vazhdon ta tregtojë gazin rus me shumë se një vit pasi u zotua se do të tërhiqej nga tregu rus i energjisë. Sipas analizës nga grupi Global Witness, kompania ishte e përfshirë në gati një të tetën e eksporteve të gazit rus të transportuar nga anijet gjatë vitit 2022.

Oleg Ustenko, një këshilltar i presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky, e akuzoi Shell-in për pranimin e "parave të gjakut". Shell tha se eksportet e raportuara ishin rezultat i "angazhimeve kontraktuale afatgjata" dhe nuk përbëjnë shkelje të ligjeve apo sanksioneve, raporton

transmetuesi publik britanik BBC. Deri më 9 maj një cisternë e madhe, që mund të transportojë më shumë se 160 000 metra kub gaz i lëngshëm natyror, u nis nga porti i Sabetas në veri të Ruisisë. Kjo ngarkesë u ble nga Shell para se të nisej për në destinacionin e saj përfundimtar, Hong Kong.



Ministria e Mbrojtjes thotë se është rritur buxheti për ngritje të kapaciteteve operacionale në mbrojtje

PRISHTINË, 2 KORRIK - "Siguria e qytetarëve dhe ruajtja e tërësisë territoriale është prioriteti i qeverisë, dhe fakti që buxheti i ndarë për Ministrinë e Mbrojtjes është në vazhdimësi në rritje e dëshmon këtë", kështu ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes. Sipas kësaj ministrie, totali i buxhetit të ndarë për çështje të mbrojtjes në fund të vitit

2022 ka arritur vlerën prej 1.6 % të GDP-së, nga 2 % të paraparë nga Këshilli i NATO-s. "Vlerë kjo që është përmbushur deri më tani vetëm nga shtatë shteti në mesin e tridhjetë e një shteteve pjesë të kësaj aleance. Rritja e dukshme e buxhetit dhe investimi në resurse humane, përgatitje të personelit ushtarakë dhe

ngritje të kapaciteteve operacionale përmes investimit në armatime, është tregues i qartë që ky sektor ka vëmendjen e duhur dhe do të fuqizohet në vazhdimësi, jo vetëm për të mbrojtur shtetin por dhe për të kontribuar në çdo operacion ndërkombëtar me qëllim të ruajtjes së stabilitetit dhe paqes", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.



Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut shënon pikënisjen e shtetësisë së Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 KORRIK - Të dielën janë bërë 33 vjet nga 2 korriku i vitit 1990, nga Deklarata Kushtetuese e Kosovës që u bë zëri unitar i përcaktimit të vullnetit politik të popullit shqiptar në Kosovë, në kuadrin kushtetues si akt vendimtar i përpjekjes historike kombëtare dhe i demokracisë autentike të popullit të Kosovës, brenda një procesi të pandalshëm për liri dhe pavarësi.

Për këtë përvjetor kanë shkruar liderët e institucioneve të Kosovës dhe ata opozitarë.

Presidentja Vjosa Osmani ka uruar 2 korrikun, duke theksuar se Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut të vitit 1990, e shpallur nga 114 delegatët e Kuvendit të Kosovës, hapi rrugën për përmbushjen e ëndrrës shekullore për Kosovën Republikë. "Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut është ngjarje emblematishe, e cila shënoi kthesën tonë historike për liri dhe pavarësi. 2 Korriku mbetet një nga datat më të rëndësishme për shtetin tonë, ngase themelet e tij qëndrojnë mbi vendimin e delegatëve të asaj kohe", ka theksuar Osmani.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka theksuar se në këtë akt shpaloseshin parimet afirmative për vetëvendosje të popullit dhe barazi mes kombeve, përballë regjimit të Serbisë që përmes shtypjes dhe represionit ruante dhunshëm asimetrinë mes rendit të qartë faktik dhe një përcaktimi juridik jashtë realitetit.



"Deklarata Kushtetuese është edhe sot shembull i shkëlqyer se çfarë do të thotë kur një popull i vendos ligjin vetvetes; se si kjo shënon përcaktim të drejtësisë në raport me vetveten dhe të barazisë në raport me tjetrin", është shprehur Konjufca.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se në historinë e përpjekjeve për Republikën e Kosovës, data e 2 korrikut e vitit 1990 është një

kapërcim i madh dhe i pakthyeshem. "E hartuar si një 'akt i vetëvendosjes politike' duke u thirrur 'në bazë të principeve të demokracisë autentike mbi respektimin e vullnetit të njerëzve', Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut 1990, mbetet një dokument i çmuar historik, si referencë për vlerat e kahjes politike të rrugëtimit tonë si komb, për republikën e parë të

Kosovës", ka deklaruar Kurti. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka pohuar se Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut ishte shprehje e aspiratave të popullit tonë për liri, demokraci dhe pavarësi, e cila i parapriu Kushtetutës së Kaçanikut, si dhe proceseve të tjera në një rrugë të gjatë e plot sakrificë, që kulmoi me shpalljen e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut e vitit 1990, ishte vazhdimësi e përpjekjeve të shqiptarëve për liri, ndërsa si akt shënon pikënisjen e shtetësisë së Kosovës. "Deklarata e 2 korrikut 1990, ishte një gur në themelet e lirisë, e cila u jetësua disa vjet më pas nga trimat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka deklaruar Haradinaj.

Gazmend Muhaxheri rizgjedhët kryetar i LDK-së në Pejë

PEJË, 2 KORRIK - Plot 3 866 anëtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë marrë pjesë në procesin zgjedhor të degës së saj në Pejë. Të dielën në Kuvendin e X Zgjedhor, Gazmend Muhaxheri u rizgjodh për mandat të ri katërvjeçar.

Mbështetja për Muhaxherin, u tha, është mbështetje për punën e mirë e angazhimit e jashtëzakonshëm të të

gjithë veprimtarëve në degën fituese të LDK-së në Pejë.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, i ka falënderuar delegatët e Kuvendit dhe të gjithë anëtarët për angazhimin e treguar në këtë proces, duke theksuar në veçanti barazinë e plotë gjinore të siguruar në të gjitha nivelet, veçanërisht për zgjedhjen e 50 % të delegatëve gra për Kuvend

Qendror. "Peja, dhe çdo degë tjetër e LDK-së në Kosovë, përveç procesit zgjedhor po zhvillon dhe një proces mobilizues me anëtarësi e qytetarë; dhe kështu dhe të forcimit të radhëve tona në një moment kritik për vendin. LDK-ja nga ky proces po del më e organizuar, më unifikuar dhe më e pasuruar me profesionistë, punëtorë, të djathtë e patriotë", ka thënë Abdixhiku.





Masat ndëshkuese të BE-së, opozita: Koha e fundit për një rrugë të re pa Kurtin

Partitë opozitare, PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, kanë reaguar ndaj masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian për Kosovën. Sipas opozitës, Kosova është në një pozicion të keq ndërkombëtarisht. Masat ndëshkuese përfshijnë: suspendimin e përkohshëm të punës së trupave të krijuara në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, mosftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë dhe suspendimin e vizitave bilaterale dhe ndaljen e programimit të fondeve për Kosovën nga IPA 2024. Javën që lamë pas Kosova nuk u përfshi në Programin e Evropës Digjitale të financuar nga BE-ja në vlerë prej 7.5 miliardë eurosh, ndërkaq Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi u përfshinë në këtë program

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka quajtur masat ndëshkuese të Bashkimit Evropian "të padrejta" dhe ka thënë se shpreson që ato të jenë të shkurtra pasi që "Kosova është një vend që ka nevojë për mbështetje në zhvillimin e saj".

Deklarata e Kurtit vjen një ditë pasi Bashkimi Evropian bëri me dije se Qeverisë së Kosovës i janë komunikuar masat ndëshkuese qysh më 28 qershor si pasojë e vlerësimit të BE-së se Kosova nuk ka ndërmarrë hapat e kërkuar për uljen e tensioneve në veri.

Kurti tha se ai do ta vazhdojë programin e tij qeverisës, pasi që shtoi se "nuk mund të bëj kompromis as me sundimin e ligjit e as me kushtetutshmërinë e vendit". "Pra, këto nuk janë sanksione. Por, është e vërtetë që

janë masa të përkohshme, por të padrejta për shkak se Kosova dhe qeveria e saj janë edhe shteti edhe ekzekutivi më demokratik pro-evropian dhe progresist", ka thënë Kurti.

Ai shtoi se "shpresojmë që këto masa të përkohshme do të jenë fort të shkurtra ashtu që edhe mbështetja edhe ndihma evropiane të jenë të plota e, mbase, edhe të rriten". "Kemi një përballje të vazhdueshme me forma të ndryshme të agresionit të Serbisë që është shtet edhe autokratik edhe pro-Rusisë dhe i paballafaquar me të kaluarën kriminale në hapësirën e ish-Jugosllavisë ku i ka shkakuar katër luftëra. Sido që të jetë, ne e bëjmë punën tonë, por le të mos harrojmë që nuk mund të bëjmë kompromis as me sundimin e ligjit as me kushtetutshmërinë e vendit tonë andaj ne do ta vazhdojmë zbatimin e programit tonë qeveritar dhe shpresojmë që këto masa të

përkohshme do të jenë fort të shkurtra ashtu që edhe mbështetja edhe ndihma evropiane të jenë të plota e, mbase, edhe të rriten për shkak se Kosova është një vend që ka nevojë për mbështetje në zhvillimin e saj", ka thënë ai. Masat ndëshkuese përfshijnë: suspendimin e përkohshëm të punës së trupave të krijuara në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, mosftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë dhe suspendimin e vizitave bilaterale, përveç atyre që fokusohen në adresimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Masat e tjera, përfshirë ndaljen e programimit të fondeve për Kosovën nga IPA 2024 (Instrumentet e Para-Anëtarësisë), propozimet e Kosovës në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor, nuk janë dorëzuar për shqyrtim nga bordi më 29

dhe 30 qershor.

Nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka theksuar se sot Kosova është e përcarë nga brenda dhe e sanksionuar nga aleatët. Ajo ka shkruar në "Facebook" se Kosova nuk i takon një njeriu. "Kosova sot: E përcarë nga brenda dhe e sanksionuar nga aleatët. Ky është rezultati i qeverisjes së Albin Kurtit. Vlerat monetare të humbura nga ky sanksionim janë pakrahasimisht më të vogla se demti që i është bërë kredibilitetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Unë e di që Kurtit nuk i bëhet vonë as për MSA-n e as për IPA. Tek e fundit ai dhe VV nuk kanë votuar për ratifikimin e MSA në Kuvend. Por, Kosova nuk i takon një njeriu", ka shkruar Çitaku.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se Kosova u pezullua në katër aspekte. "Pezullim i fondeve të BE-së, pezullim i MSA-së, pezullim i takimeve të nivelit të lartë, pezullim i vizitave bilaterale. Sanksione Kosovës, avancim për Serbinë. Si qenka kjo fitore për ne? Teksa ne përjashtohemi nga programet ushtarake me NATO-n; Serbia vazhdon misionet paqeruajtëse me ta. Teksa ne humbasim nga programi 7.5 miliardësh për zhvillim digjital, shtetet e rajonit ecin me hapa të mëdhenj. Kam takuar në vazhdimësi biznese nga komuniteti i IT-së, punëdhënës të jashtëzakonshëm, me potencial dhe më të madh. Sot, humbasin ata dhe të rinjtë që do

të punësonin në vazhdimësi", ka shkruar Abdixhiku.

Ai ka theksuar se Albin Kurti dhe politika e tij nuk e bëjnë dot Kosovën shtet evropian. "Kosova nuk ka qenë kurrë më keq ndërkombëtarisht sesa sot. Serbia nuk ka pasur kurrë më shumë përkrahje sesa tani. Koha e fundit për një rrugë të re pa Kurtin dhe politikën e tij të izolimit", ka theksuar Abdixhiku. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se duke qenë i vetëdijshëm se Kosova me këtë kryeministër po hyn në një rrugë pa krye, para pak ditësh ka kërkuar mocion për shkarkimin e Albin Kurtit. "Sanksionet e BE-së ndaj Kosovës dhe paralajmërimet e ShBA-së se Qeveria e Kosovës është në rrugë të gabuar, e dëshmojnë se sa e rrezikshme dhe e pashpresë është gjendja, e cila fatkeqësisht do të shkojë duke u përkeqësuar gjithnjë e më shumë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka thënë se sot është koha të veprohet dhe të bashkohen të gjithë ata që interes parësor e kanë Kosovën, qofshin në opozitë ose edhe deputetë të shumicës, e ta jetësojnë mocionin për shkarkimin e kësaj qeverie. "Hezitimi për të vepruar në kohë të një krize kaq të thellë e me pasoja të paimagjinueshme për vendin është bashkëfajësi. Mocioni për shkarkimin e Albin Kurtit, sot është interes kombëtar", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Bill Klintoni të hënën në Tiranë



Tiranë, 2 korrik - Presidenti i 42 i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bill Klinton, do të vizitojë për herë të parë Shqipërinë me 3 dhe 4 korrik 2023. Klintoni dhe delegacioni që e

shoqëron do të mbërrijë në Tiranë ditën e hënë, më 3 korrik, pasdite, ku në orën 19:00 do të pritët nga kryeministri Edi Rama në një ceremoni të posaçme zyrtare në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit" përballë

Kryeministrisë, me pjesëmarrjen edhe të qytetarëve. Pas ekzekutimit të himneve kombëtare të ShBA-së dhe Shqipërisë, kryeministri Edi Rama dhe presidenti i 42 i ShBA-së, Bill Klinton, do ta bëjnë

parakalimin ceremonial dhe do t'i nderojnë flamujt e dy vendeve.

Në orën 19:05 kryeministri Edi Rama do ta mbajë fjalën e rastit dhe më pas do ta ftojë zotin Bill Klinton ta marrë çmimin e

akorduar.

Në orën 19.25 do të zhvillohet ceremonia e nderimit të presidentit të 42 të ShBA-së, Bill Klinton, me "Yllin e Mirënjohjes për Arritjet Publike" që do të pasohet nga fjalimi i presidentit.

Vuçiqi thotë se pret "ofensivë të re" nga Kurti

PRISHTINË, 2 KORRIK - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se pret një "ofensivë të re" nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, duke pretenduar se kjo "ofensivë" do të përkohet me ofensivën e forcave ukrainase në luftën kundër Rusisë.

Në një intervistë të dhënë për TV Prva, Vuçiq përsëriti pretendimet se aleatët perëndimorë nuk shqetësohen për të drejtat e serbëve në Kosovë.

Ai tha se të drejtat e tyre po shkelen, se ata "i janë ekspozuar terrorit" dhe se pjesëtarët e komunitetit serb që janë arrestuar në javët e fundit në Kosovë janë të pafajshëm.

Deklarata vjen në kohën e tensioneve të rritura në veri të Kosovës, ku popullata shumicë është serbe. Që nga 29 maji serbët atje protestojnë kundër kryetarëve shqiptarë të komunave dhe kërkojnë tërheqjen e njësisë speciale të Policisë së Kosovës. Autoritetet e Kosovës i kanë



arrestuar disa pjesëtarë të komunitetit serb, që dyshohet

se kanë marrë pjesë në dhunën kundër pjesëtarëve të

misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, Policisë së Kosovës dhe

gazetarëve që raportojnë nga veriu.

Të arrestuarit janë identifikuar si: Dushan Obrenović, Radosh Petrović, Milun Millenković-Lune, Dalibor Spasić, Urosh Vukashinović, Nemanja Vlashković, Millan Bozhović dhe Slladan Trajković. Të gjithë janë në paraburgim, përveç Petrovićit i cili po mbrohet në liri.

Serbia dhe pjesëtarë të komunitetit serb në Kosovë i konsiderojnë këto arrestime si arbitrarë.

Komuniteti ndërkombëtar ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia t'i ulin urgjentisht tensionet dhe që Prishtina t'i organizojë zgjedhjet e reja. Së fundi, BE-ja ka bërë me dije edhe për masa ndëshkuese të përkohshme të vendosura ndaj Kosovës.

Ndërkohë, Vuçiqi ka përsëritur se Serbia nuk do t'i vendosë sanksione Rusisë për luftën në Ukrainë dhe ka deklaruar se nuk ia kanë dërguar "as edhe një armë të vetme" as Rusisë e as Ukrainës.

“Ku është opozita?”



Shkruan: Milazim KRASNIQI

“Ku është opozita?” është pyetje që dëgjohej shpesh. Pastaj shpaloset zhgënjimi pse

ajo nuk po bën më shumë, për ta frenuar arrogancën e qeverisë Kurti. Por, në këtë rast, po harrohet se opozita në Kosovë ekziston gati simbolikisht. Pse? Sepse votuesi shqiptar ka vendosur në zgjedhjet e kaluara parlamentare që në Kosovë të mos ketë opozitë reale. Votuesi ka vendosur që të gjithë fuqinë t’ia japë një partie e një personi: LV-së dhe Albin Kurtit. Ja ilustrimi: AAK-ja e Haradinajt ka një deputet më

pak se sa Lista Serbe!!! Merreni me mend: Ramush Haradinaj ka më pak fuqi në Kuvend se sa Millan Rakiqi! LDK-ja ka vetëm shtatë deputet më shumë se sa Lista Serbe. PDK-ja ka nëntë deputet më shumë se sa Lista Serbe. Pra, partia që e ka formuluar projektin e pavarësisë (LDK) dhe dy që parti që kanë dalë nga procesi i luftës çlirimtare, janë refuzuar keqas nga elektorati shqiptar. Prandaj opozita nuk ka sot fuqi, që ta frenojë

mujsharinë e Kurtit. Votuesi duhet të kuptojë se e ka lënë vendin pa opozitë reale. Më saktë, duhet ta kuptojë se i ka dhënë Kurtit pushtet absolut. Votuesi, nëse është i pakënaqur, duhet të distancohet nga kjo politikë. Nëse votuesi i 14 shkurtit 2021 është i kënaqur me këtë qeverisje edhe nën sanksione, në izolim dhe me krizë gangrenoze në veri, e cila i konvenon Ruisisë, mund ta mbajë Kurtin në pushtet, deri

sa të dorëzohet vetë Kurti. Pra, duhet të kuptohet, megjithëse me vonesë, se votuesi me dorën e vet e ka shkatërruar opozitën- mundësinë e korrigjimit të qeverisë arrogante. Natyrisht opozita duhet të kërkojë edhe rrugë alternative, sepse dështimi i qeverisë Kurti po e fundosë shtetin. Por, ato rrugë alternative duhet të jenë brenda kuadrit ligjor e jo të dhunshme, si ato që përdori në opozitë LV-ja.

Me postë e TikTok, paratë false vërshojnë në treg

Prishtinë, 2 korrik - Qindra mijëra euro false dyshohet se qarkullojnë në tregun e Kosovës. Ardianë Pajaziti nga Prishtina thotë se është përballur vetë me monedha të tilla. “Duke blerë bukë. Punëtorja me mirësjellje më ka treguar se paratë janë false. Monedha ka qenë 2 euro. Kjo përvojë më ka bërë të jem më e kujdesshme se çfarë monedhash pranoj në shërbime të ndryshme”, thotë Pajaziti për Radion Evropa e Lirë. “E kupton që monedha metalike dy euro është false, sepse është më e lehtë, pra dallon trashësia dhe diametri. Imazhi i saj është më i dobët dhe ndonjëherë ka ndonjë shkronjë të deformuar”, thotë bashkëqytetarja e saj, Fjolla Vukshinaj, e cila ka hasur në para false.

Praninë e parave false e konfirmojnë edhe aksionet e policisë së Kosovës për

konfiskimin e tyre dhe arrestimin e falsifikuesve.

Nga janari deri në prill të këtij viti policia ka iniciuar 363 raste për veprën penale “falsifikim i parasë”.

Në një aksion më 13 prill u konfiskuan 10 600 euro false. Të gjitha paratë e konfiskuara ishin monedha prej dy eurosh.

Në një tjetër aksion në dhjetor u konfiskuan 63 mijë euro false.

Një shumë prej 375 000 eurosh false - që të gjitha bankënota prej 100 dhe 50 eurosh - u konfiskua në vitin 2021.

Kohë më parë u arrestua edhe një grup kamerierësh, të cilët u zunë duke shpërndarë para false te klientët në rajonin e Prizrenit.

Së paku në dy raste të konfiskimit të mijëra eurove false nga Policia e Kosovës, origjina e tyre ishte Maqedonia e Veriut dhe Turqia.

Në grupe të ndryshme në rrjete sociale, po ashtu, pretendohet se



në shumë raste paratë false vijnë prej jashtë Kosovës. Në aplikacionin TikTok ka një

numër profilesh që reklamojnë paratë false. Poshtë këtyre njoftimeve ka qindra komente të

personave me emër e mbiemër, që kërkojnë të blejnë vlera të ndryshme të parave false.

Privatizimi tkurr tokat bujqësore

PRISHTINË, 2 KORRIK - Shndërrimi i tokave bujqësore në toka për qëllime ndërtimore apo industriale është bërë dukuri shqetësuese, pasi zvogëlon mundësitë për prodhimin e kulturave bujqësore, thonë ekspertë të bujqësisë në Kosovë. Ndër faktorët kryesorë që ka sjellë këtë gjendje, sipas tyre, është procesi i privatizimit.

Të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës, të siguruar nga Radio Evropa e Lirë, tregojnë se vetëm gjatë vitit të kaluar mbi pesë hektarëve tokë bujqësore u është ndërruar destinimi në tokë për qëllime jobujqësore.

Në këtë ministri, nga viti 2019 deri më 2022, janë bërë mbi 350 kërkesa për ndryshimin e tokës bujqësore në tokë për qëllime të tjera - prej të cilave shumica janë miratuar. Se për sa sipërfaqe tokë bëhet



fjalë saktësisht nuk është e qartë. Nga viti 2019 deri më 2022 në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës janë paraqitur 355 kërkesa në

total për ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë për qëllime të tjera. Nga kjo shifër, 307 kërkesa kanë marrë pëlqimin dhe 48 nga to janë refuzuar.

Salih Salihu, profesor në Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës, thotë se institucionet duhet ta ndalojnë ndërrimin e destinacionit të

tokave bujqësore. Sipas tij, është lehtë e vërejtshme që tokat deri vonë bujqësore - kryesisht rreth rrugëve magjistrale - janë shndërruar në zona industriale, objekte afariste e komerciale, apo banesa kolektive.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), vendi ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 10.905,25 kilometrash katrorë.

Sipërfaqja e tokës së përgjithshme bujqësore, sipas ASK-së, llogaritet të jetë 512 mijë hektarë.

Ndërkaq, hapësira e shfrytëzuar në vitin 2021 ka qenë 420 mijë hektarë.

Kosova, prej vitesh, përballet me deficit të lartë tregtar, që do të thotë se importon më shumë sesa eksporton.

Në mesin e produkteve të importuara bëjnë pjesë edhe kulturat bujqësore, si qepët, që, sipas ekspertëve të bujqësisë, janë lehtë të kultivohen.

Pagat në Kosovë, më pak se 140 euro rritje për një dekadë

PRISHTINË, 2 KORRIK - Nga viti 2015 paga e Ridvan Berishës, punëtor në sektorin e ndërtimit në Kosovë, është rritur jo më shumë se 100 euro. Për punën që bën në një kompani private para tetë vjetësh është paguar rreth 450 euro bruto, kurse sot merr rreth 550 euro. “Çfarë të them, ndoshta 100 euro duken shumë por, krahasuar me çmimet që janë rritur, sidomos vitin e kaluar, kjo rritje është shumë pak”, thotë Berisha për Radion Evropa e Lirë.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), paga mesatare bruto në vend për dhjetë vjet është rritur 138 euro. Nga 383 euro sa ka qenë në vitin 2012, ajo është bërë 521 euro në vitin 2022.

Paga mesatare bruto në Kosovë u rrit për 138 euro në dhjetë vjet. Krahasuar me Maqedoninë e Veriut, Kosova kishte rritje më të ulët, ndërsa krahasuar me Shqipërinë ajo kishte rritje më të lartë.

Sipas aktiviteteve ekonomike, pagat më të larta në Kosovë janë në sektorin e energjisë, që arrijnë 970 euro, pasuar nga sektori i informimit dhe komunikimit, që janë rreth 900 euro.

Paga më e ulët, në vlerë prej 323 eurosh, është tek akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim.

Pagat më të larta në Kosovë, në vitin 2022, kanë qenë në sektorin e energjisë - rreth 970 euro, tregojnë të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Më së paku janë paguar punonjësit në akomodim dhe shërbime me ushqim - rreth 320 euro.

Ekspertë të çështjeve ekonomike

thonë se niveli i ulët i rritjes së pagës mesatare në Kosovë është pasojë e zhvillimit të ngadalshëm ekonomik gjatë një dekade.

Në dhjetë vjetët e fundit rritja mesatare ekonomike në Kosovë ka qenë 4 deri në 5 për qind.

Të dhënat e fundit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) tregojnë se në vitin 2023 Kosova do të ketë rritje ekonomike për 3.5 për qind, ndërsa në vitin 2024 për 4 për qind.

Profesori i Makroekonomisë dhe Mjedisit në Biznes në Universitetin e Prishtinës, Nagip Skenderi, thotë se në Kosovë nuk ka pasur ristrukturim të ekonomisë gjë që, sipas tij, do të mundësonte zhvillim më të madh. “Ne si ekonomi e Kosovës më shumë jemi përqendruar në sektorin e shërbimeve sesa në prodhim, e kjo ka bërë që të ketë paga të ulëta. Gjithkund shërbimet paguhen më pak se shërbimet e prodhimit”, thotë Skenderi për Radion Evropa e Lirë.

Në programin katërvjeçar të Qeverisë së Kosovës qëndron zotimi për orientimin e ekonomisë kah prodhimi dhe eksporti.

Qeveria zotohet se do t'i mbështesë bizneset në blerjen e makinerisë prodhuese dhe përpunuese me synim digjitalizimin e procesit të përpunimit dhe rritjen e kapaciteteve përpunuese dhe prodhuese.

Këtë muaj, Ministria e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë e Kosovës ofroi përkrahje financiare në vlerë prej një milion eurosh për



blerjen e makinave prodhuese dhe përpunuese për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme prodhuese. Qëllim i përkrahjes së këtyre bizneseve u tha se është rritja e investimeve, rritja e konkurrencës dhe hapja e vendeve të reja të punës

Berim Ramosaj, ligjërues i lëndëve ekonomike në Universitetin e Prishtinës, thotë për Radion Evropa e Lirë se produktiviteti i punës në Kosovë është i ulët, në veçanti në sektorin publik, andaj edhe pagat, sipas tij, janë solide. “Nëse e shohim në aspektin e logjikës ekonomike, vërtet lë për të dëshiruar niveli i produktivitetit në sektorin publik, kur kemi parasysh se edhe jemi të mbingarkuar me numrin e të

punësuarve. Kështu që, faktikisht, sado që na duket se është pagë e ulët në sektorin publik, mendoj se është mjaft e lartë, marrë parasysh shkallën e ulët të produktivitetit të punës”, thotë Ramosaj.

Mbi 80 mijë të punësuar në sektorin publik në Kosovë marrin pagë mesatare bruto 604 euro, ndërsa paga mesatare bruto në sektorin privat është 473 euro. Nivelin e pagës mesatare bruto në Kosovë e ka diktuar edhe paga minimale, e cila nga viti 2011 nuk ka ndryshuar dhe sillet nga 130 deri në 170 euro.

Në dhjetë vjetët e fundit qytetarët e Kosovës janë përballur me rritje të çmimeve të konsumit, gjë që ka ndikuar në standardin e tyre jetësor.

Nëse krahasohet viti 2012 me vitin 2022, norma mesatare e inflacionit është 9.1 për qind më e lartë.

Rritje më e theksuar e çmimeve të konsumit është shënuar në vitin 2022, kur norma mesatare e inflacionit ka qenë gati 12 për qind.

Ridvan Berisha thotë se me pagën që merr nuk arrin t'i blejë gjërat e njëjta që i ka blerë vetëm një apo dy vjet më parë për familjen e tij 5-anëtarëshe. “Krejt sendet ushqimore janë më shtrenjtë. Çmimet janë rritur shumë”, thotë ai.

Nga viti 2021 deri në vitin 2022, kur çmimet e konsumit kanë shënuar rritjen më të lartë, paga mesatare bruto në Kosovë është rritur për vetëm 37 euro.

Bletarët në hall me motin

PRISHTINË, 2 KORRIK - Moti me shi dhe temperaturat e ulëta kanë goditur rëndë bletarët në Kosovë. Maliq Koskoviku, bletar nga Prishtina, nuk është dorëzuar dhe është detyruar të shpenzojë para shtesë për të mbajtur gjallë 270 kosheret me bletë që i ka.

Ai thotë për Radion Evropa e Lirë se ka dërguar kërkesa për ndihmë në komunën e Prishtinës dhe në autoritetet qendrore. Megjithatë, ai ende është në pritje të ndihmës.

Për një koshere me bletë ai thotë se ka 100 euro shpenzime. Por, Kosoviku thotë se do të vazhdojë të mbajë bletë pavarësisht prej situatës aktuale, siç thotë ai “katastrofale”, pasi kjo është puna e tij primare. Megjithatë, Koskoviku tregon se ka dëgjuar nga bletarë të tjerë se do të heqin dorë për shkak të shpenzimeve të mëdha.

Përveç mbledhjes së mjaltit, Maliq Koskoviku merret me shumimin e bletëve, me qumështin e tyre, polenin, propolisin dhe helmin e bletëve.

“Bleta është si një minierë, por janë të paktë ata që e kanë si punë të parë”, thotë ai.

Nga bletët mund të krijohen shumë produkte nga të cilat njerëzit mund të kenë përfitime shëndetësore, pasi bletët mbledhin nektar nga mbi 300 lloje të luleve. “Më shumë te ne në popullatë njihet mjalti, mirëpo të gjitha gjërat e tjera janë më të mira se mjalti. Shumë më i shëndetshëm është poleni që ka diku mbi 10 vitamina, shërben për ngritjen e imunitetit. Në kombinim me mjaltë përdoret për rregullimin e tensionit, për diabetin. Sidomos është për njerëzit që kanë probleme me anoreksi”, thotë ai.

Nga kosheret e bletëve bëhet edhe inhalim.

Koskoviku thotë se zakonisht inhalimi mund të bëhet nga muaji prill, por për shkak të motit të paqëndrueshëm këtë vit ka nisur në qershor, pasi për këtë gjë kërkohet që temperatura e kosheres të jetë nga 34 deri në 37 gradë celsius.



“Kush sheh vetëm komplete, është i pari që komploton”

Pra, u bëmë edhe një komb i teoricienëve të kompleteve. Por, duke supozuar se mund të jetë inkurajuese, jemi në shoqëri të mirë. Kjo është të paktën ajo që del nga shifrat krahasuese (me amerikanët, brazilianët, francezët...) të raportuara nga Pierre-André Taguieff në librin “Komplotizmi”.

Francez, i lindur në vitin 1946, Taguieff është një historian i ideve dhe sociolog për një kohë të gjatë. Qasja e tij ndaj një subjekti në evolucion të vazhdueshëm, siç është konspiracionizmi, është pa pasion. Para së gjithash i vetëdijshëm se sa dritëshkurtër, në mos kundërproduktiv, është qëndrimi “progresiv” që e patologjizon teoricienin mesatar të konspiracionit duke e bërë atë të sëmurë (paranojak, skizofren), gjë që e kriminalizon ose e bën budalla atë.

Në realitet, në mos thjesht një “mendim”, konspiracioni është një vizion i botës, i historisë, i pushtetit, i shoqërisë, i cili ka rrënjë shumë të largëta. Ardhja e dixhitale e ka përditësuar, duke shtuar objektiva të reja (globalizimi, Big Pharma, manjatë të teknologjisë së lartë, mjeshtra të Big Data...) në bagazhin e gogolëve atavistë (hebrenj, masonë, financierë kozmopolitanë...).

Pavarësisht se sa i modernizuar në teknika, diskursi konspirativ zbulon një detyrim të pashmangshëm për të përsëritur veten, një paaftësi për t'u rikrijuar. Sidoqoftë, nuk ka dyshim se ardhja e internetit u ka dhënë teorive të konspiracionit jo vetëm një shtysë të re, por mbi të gjitha një rritje sasiore spektakolare, duke zgjeruar zonën e basenit, duke rritur shpejtësinë e përhapjes, aftësinë për bindje. Profesor Taguieff, siç shkruani ju, rreth mesit të shekullit të nëntëmbëdhjetë retorika konspirative duket se është fiksuar një herë e përgjithmonë. Por cilat janë veçoritë e saj në shekullin XXI?

“Në një nivel të përgjithshëm, vala e fundit e konspiracionit mund të lexohet vetëm si një reagim ndaj globalizimit. Një globalizim që hedh në erë pikat e referencës, i cili relativizon, shkrin sigurinë dhe për rrjedhojë përjetohet si një proces provokues ankthi.

Ankthi social pakëson besimin në shpjegimet zyrtare dhe banalizon kulturën e dyshimit, mosbesimit ndaj autoriteteve tradicionale, politike dhe intelektuale. Në internet ushqehemi me narrativa, besime, shpjegime alternative për ngjarjet që na shqetësojnë më shumë, në rrjetet sociale mbretëron një hiper-relativizëm konjitiv. Në këtë kuptim, teoria konspirative bashkëkohore mund të konsiderohet një patologji e demokracisë komunikuese, e cila nuk ka më kufij”.

Megjithatë, në njëzet vitet e fundit, obsesioni i konspiracionit ka marrë konotacione që, vetëm



pjesërisht mund të gjurmohen në përhapjen e rrjeteve sociale.

“Diskursi konspirativ diversifikohet duke ndjekur modën e re politike apo kulturore. Së bashku jemi dëshmitarë të një përshpejtimi dhe diferencimi të fenomenit. Rrëfimet klasike konspirative karakterizoheshin nga një strukturë deduktive, ndërsa ato bashkëkohore ecin në mënyrë induktive”.

Çfarë do të thotë?

“Teoria tradicionale e konspiracionit zbatonte në realitet një skemë interpretuese të bazuar në besimet shoqërore shpesh me origjinë fetare, për shembull duke parë dorën e padukshme të Satanait prapa rrjedhës së historisë. Nga ana tjetër, teoria e neo-konspiracionit ndërton shpjegime alternative, përgjithësisht false, duke u nisur nga një qëndrim hiperkritik ndaj “versioneve zyrtare” të ngjarjeve. Në sferën e teorisë bashkëkohore të konspiracionit, elementi vendimtar psikosocial është shtrembërimi që ndodh, midis dëshirës për transparencë të theksuar prej një një kulture demokratike që predikon afërsinë, menjëhershmerinë, qartësinë... dhe perceptimit të një logjike të errët, e cila mendohet se drejton ngjarjet që i shpëtojnë një interpretimi racional. Mendimi konspirativ lulëzon në hendekun midis një kërkesë për transparencë dhe një realiteti të perceptuar si opak, irracional”. Teoria e konspiracionit është një kritikë e Fuqive që tani duket se kanë pushtetin. Jo vetëm në regjimet autoritare dhe/ose joliberalë – filli Putin-Erdogan-Orbán... – por edhe në demokracitë që ne besojmë se ishin solide, siç është rasti Trump. “Populizëm” është një fjalë që duhet përdorur me kujdes, shkakton abuzim. Por a ka afërsi zgjedhore midis politikave populiste dhe teoricienëve të konspiracionit?

“Të dy “izmat” – populizmi dhe konspiracionizmi – e kanë pikënisjen nga një kundërvënie midis Popullit – të mirë, të ndershëm, por të ofenduar – dhe pushtetarëve të padukshëm në thelb të këqij, cinikë, gënjeshtarë, që komplotojnë kundër Popullit, që e dominojnë atë, e manipulojnë, mashtrojnë, shfrytëzojnë. Iluzioni demokratik ruhet duke vënë në skenë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë mes liderit dhe popullit. Lideri nuk humbet kurrë një mundësi për të kujtuar origjinën e tij popullore dhe për të nënvizuar se si objektivi parësor i politikës së tij është të ndihmojë të varfërit. Për të delegitimuar kundërshtarët, për të nisur gjuetinë e shtrigave apo për të justifikuar spastrimet në institucione, lideri nuk heziton të përdorë narrativa konspiracioniste kundër Perëndimit apo “judeo-sionizmit”. Imazhet dhe retorika politike e të ashtuquajturve populizma ushqejnë teoricienët e konspiracionit me një përzierje anti-elitarizmi dhe pakënaqësie ndaj utopive të “demokratizmit”. Ja pra: konspiracionizmi është gjithashtu zhgënjim, një reagim hiper-skeptik ndaj premtimeve të paplotësuara të modernitetit demokratik. Premtimet e emancipimit, barazisë, drejtësisë sociale... A është kjo arsyeja pse teoritë e konspiracionit tërheqin fansat edhe në të majtë?”

“Në sytë e atyre që janë bërë mosbesues ndaj narrativave të mëdha të çlirimit, rrjedha e historisë duket gjithnjë e më pak e kuptueshme. Teoria e konspiracionit bën të mundur që në mënyrë imagjinare t'i shpëtojmë këtij zhgënjimi, kësaj ndjenje tradhtie dhe i jep zë inatit që lind prej saj”.

Konspiracionisti është një anti-elitar, por i një lloji shumë të çuditshëm. Përkundrajt të vërtetave zyrtare të ushqyera, ai e konsideron veten si magazinë e një dijeje thujajse nismëtare,

e zoterike, e cila i lejon të shohë prapa asaj që duket...

“Rrëfimet konspirative vihen në lëvizje nga nevoja për të gjetur një rend pas ngjarjeve. Kjo është për t'i shpëtuar ankthit të shkaktuar nga një botë e perceptuar si kaotike. Zhgënjimi ose armiqtësia ndaj shpjegimeve zyrtare çon në pakënaqësi dhe prodhon dyshime sistematike. Ky dyshim e regjistron personin që e mbarat atë në një lloj aristokracie shpirtërore që e forcon ose i rikthen vetëvlerësimin. Kështu, konspiracionisti i jep vetes një shenjë dallimi kognitiv, atë të ekspertit alternativ.

Një lloj i zgjedhuri.

“Ndjenja unike duket të jetë një faktor i rëndësishëm në respektimin e pikëpamjeve konspirative. Duke qenë i kënaqur të dijë atë që të tjerët nuk e dinë, teoricieni i konspiracionit ndahet nga tufa e njerëzve syleshë që pranojnë në mënyrë pasive shpjegimet zyrtare”.

Teoricieni i konspiracionit paralajmëron, akuzon, dënon. Por a dëshiron vërtet t'i zbërthejë komplotet që denoncon apo preferon t'i mbajë ato të errëta, midis luksit dhe të papriturës, në mënyrë që të përjetësojë misterin e tyre?

“Në fakt, është e mundur të mendohet se, pavarësisht pretendimeve për çmitizim, teoricienët e konspiracionit mbeten të lidhur mbi të gjitha me besimin e tyre. Është një besim që i jep kuptim jetës së tyre”.

Teoria e konspiracionit është një mënyrë për të rimagjepsur botën, një shtrirje e të menduarit mitik, një magji po deshët?

“Pjesërisht po, por është edhe pasqyrim i një realiteti historik dhe shoqëror ku funksionimi i zakonshëm i politikës është ai i ekuilibrit të pushtetit dhe i luftës për pushtet. Përpjekje që nënkupton veprime pak a shumë sekrete për prodhimin e konsensusit, për të diskredituar apo manipuluar kundërshtarët”.

Eshtë risi?

“Jo. Por komplotet e rreme nuk duhet të na bëjnë të harrojmë se ka edhe të vërteta. Dhe çështja bëhet edhe më e ndërlikuar nëse mendojmë se shpesh, në konspiracione reale, komplotistët përdorin si armë komplete fiktive. Me pak fjalë, teoria e konspiracionit mund të bëhet një mjet në duart e komplotistëve të vërtetë.


Ju shkruani se metoda më efektive për të luftuar konspiracionin “është kritika e ftohtë çmitizuese, e cila konsiston në refuzimin e tezës së konspiracionit pa sulmuar mbështetësit e tij”. Por a ka ndonjë mënyrë për të folur me teoricienin e konspiracionit apo është humbje kohe?

“Shumë konspiracionistë në fakt mund të konsiderohen si psikopatë ose sociopatë, njerëz me të cilët është e pamundur të hysh në një dialog bazuar në argumente racionale dhe të dhëna objektive. Le të shtojmë se, sipas studimeve të ndryshme, ata që besojnë në një teori të caktuar konspirative priren të besojnë edhe në shumë teori të tjera të të njëjtit lloj. Jo vetëm kaq. Studimet na tregojnë gjithashtu se teoritë e konspiracionit besohen kryesisht nga vetë personat që janë të prirur të komplotojnë ose të jenë pjesë e kompleteve. Tipa që për këtë arsye duket se projektajnë dëshirën e tyre konspirative tek të tjerët. Shkurt, kur një individ mendon se “po komplotojnë”, ai thotë edhe “në vend të tyre, do të bëja të njëjtën gjë”.

A është ajo që psikanaliza e quan “identifikimi me agresorin”?

“Konspiracionisti imagjnon të jetë pjesë e një elite njohëse, por në këtë mënyrë ai përshtatet në një komunitet besimtarësh, të cilët, duke iu përmbajtur të njëjtave teori, karakterizohen nga një konformizëm i fortë ideologjik grupi. Ky sektarizëm, ky dogmatizëm e bën dialogun të perealizueshëm”. / Il Venerdì – Bota.al

Parisi si “tenxhere me presion”. Prapa trazirave që po e çojnë Francën drejt gjendjes së jashtëzakonshme



Joseph DOWNING

Prej disa ditësh kanë shpërthyer trazira në Nanterre, një periferi e Parisit, pas vrasjes nga policia të një djali 17-vjeçar, të quajtur Nahel M. Një hetim për vdekjen e tij është në vazhdim, por situata tashmë ka shkaktuar protesta dhe shumë zemërim. Sido që të përfundojë hetimi, incidenti është pjesë e një problemi kompleks dhe me rrënjë të thella.

Ajo risjell kujtesën e dhunës që u përhap me shpejtësi në periferi të qytetit në vitin 2005, që zgjati më shumë se tre javë dhe e futi vendin në një gjendje të jashtëzakonshme. Shumë nga problemet pas trazirave të atëhershme mbeten të pazgjidhura edhe sot e kësaj dite dhe madje janë përkeqësuar nga përkeqësimi i marrëdhënieve midis policisë dhe publikut.

Gjatë punës sime të gjerë në terren në pronat periferike të Parisit, Lionit dhe Marsejës, kam parë dhe dëgjuar vetë ankesat që tani po bërtiten në rrugët e Nanterres.

Periferitë dhe varfëria

Disa periferi të qyteteve të mëdha franceze kanë vuajtur

për dekada nga ai që është cilësuar si “hipermargjinalizimi” më i keq në Evropë. Strehimi dhe shkollimi me cilësi të dobët kombinohen me izolimin gjeografik dhe racizmin për ta bërë praktikisht të pamundur që njerëzit të kenë një shans për të përmirësuar rrethanat e tyre.

Provat kanë treguar prej kohësh se njerëzit që jetojnë në periferi të varfra mund të presin që të përballen me diskriminim bazuar në vetë faktin që jetojnë në ato periferi, kur aplikojnë për një punë. Edhe vetëm të kesh një emër të caktuar në CV-në tënde, mund të të përjashtoj nga puna për shkak të diskriminimit të përhapur racor.

Si rezultat, pakënaqësia mes të rinjve në këto periferi ka dekada të tëra që zien. Trazirat e para, si këto që po ndodhin aktualisht në Paris, u zhvilluan në Lyon qysh në vitet 1990.

E megjithatë, përtej momenteve të krizës, duket se nuk ka praktikisht asnjë diskutim nga lidhshipi francez se si të trajtohen problemet që në xisin kaq shumë zemërim në periferi.

Presidenti Emmanuel Macron paraqitet si i përkushtuar për ri-industrializimin e Francës

dhe rigjallërimin e ekonomisë. Por vizioni i tij nuk përfshin ndonjë plan për përdorimin e rritjes ekonomike, për të sjellë mundësi në periferi ose, e parë anasjelltas, për të shfrytëzuar potencialin e periferisë për të nxitur rritjen ekonomike. Në dy mandate presidenciale, ai nuk ka arritur të prodhojë një politikë koherente për zgjidhjen e disa prej problemeve kyçe të periferisë.

Brutaliteti i policisë

Brutaliteti i policisë është një temë e madhe shqetësuese në Francë për momentin, përtej incidentit të Nanterre. Në fillim të këtij viti, organizata ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Këshilli i Evropës, ndërmori hapin e jashtëzakonshëm, kur kritikoi drejtpërdrejt policinë franceze për “përdorim të tepruar të forcës” gjatë protestave kundër reformave të pensioneve të Macronit.

Policia duket se ka ngecur në një qasje të tipit, “gjithçka ose asgjë”. Në një intervistë të fundit ku ndihmova në realizimin e një dokumentari në periferi të Marsejës, banorët vunë në dukje shkurtimeve e njëpasnjëshme të oficerëve të policisë me bazë në komunitet,

si arsye kryesore për rritjen e tensionit midis popullsisë dhe policisë. Ndërkohë protestat janë pritur me gaz lotsjellës dhe shkopinj gome.

Qeveritë e njëpasnjëshme kanë përdorur policimin për të kontrolluar popullsinë për të parandaluar trazirat politike, duke gërryer legjitimitetin e zbatimit të ligjit.

E megjithatë, policia është jashtëzakonisht armiqësore ndaj reformave, një qëndrim që ndihmohet dhe nxitet nga sindikatat e tyre të fuqishme dhe vetë Macroni, i cili ka nevojë që policia të shtypë opozitën ndaj reformave të tij.

Macron i krahasuar me Sarkozy

Ish-presidenti Nicolas Sarkozy është famëkeq për ndezjen e tensioneve gjatë trazirave të vitit 2005, duke i quajtur njerëzit e përfshirë “llum”, të cilët duhej të laheshin me ujë me presion nga periferitë. Edhe Macroni është kritikuar vazhdimisht për një ton arrogant gjatë karrierës së tij politike, duke bërë gafa të shumta, përfshirë sugjerimin që një punëtori të papunë i mjafton të “kalojë rrugën”, për të gjetur punë.


Megjithatë, përgjigja e tij për

vdekjen e Nahelit ka qenë shumë larg asaj të Sarkozy-t. Ai e ka quajtur vrasjen “të pafalshme” dhe ka mbajtur një takim emergjence për të kërkuar një zgjidhje për krizën. Një udhëtim për të parë performancën e Elton John-it ndërsa ndodhnin trazirat ndoshta nuk ishte i këshillueshëm dhe komentet për të rinjtë që ishin “të dehur” nga videolojërat, ishin disi të gabuara, por Macroni të paktën është përpjekur të qetësojë tensionet dhe të mos i ndezë ato.

Megjithatë, një problem kyç për të është natyra e përhapur dhe e decentralizuar e protestuesve. Nuk ka lidhshirësi për t’u takuar dhe negociuar, dhe nuk ka kërkesa specifike që duhet të plotësohen për të ulur tensionin. Ashtu si në vitin 2005, trazirat po ndodhin në mënyrë spontane.

Kjo e bën shumë të vështirë ndalimin e përshkallëzimit nga ana e qeverisë. Dhe thekson nevojën për një përgjigje shumë më të gjerë dhe të menduar për të trajtuar problemet e rrënjësura, disa dekadëshe, të perspektivës së dobët sociale dhe brutalitetit policor në periferi të qyteteve franceze. / *The Conversation – Bota.al*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Batatina shpall kandidaturën për trajner të Kosovës

PRISHTINË, 2 KORRIK - Trajneri Tahir Batatina ka shfaqur kandidaturën për pozitën e përzgjedhësit të Përfaqësuesja e Kosovës. Kosova është ende në kërkim të një trajneri të ri, pas

shkarkimit të Alain Giresse muajin e kaluar. Batatina është shfaqur i gatshëm për të udhëhequr me "dardanët" "Kur kam qenë i gatshëm në 2013 me e marrë një Llap në lloç, kur ka qenë duke rënë në

kategorinë e tretë dhe me qenë sot një skuadër pretendente për Evropë, jam i gatshëm pas dhjetë viteve me e menaxhu një Kombëtare si Kosova", ka thënë Batatina në "Dueli Sportiv".

Përveç Llapit, Batatina nuk ka punuar me ndonjë skuadër tjetër. Ai me skuadrën nga Podujeva ka fituar dy herë trofeun e Kupës së Kosovës dhe një herë atë të Superkupës.



'Dardanët' vazhdojnë përgatitjet për 'Eurobasket 2025'



PRISHTINË, 2 KORRIK - Basketbollistët e Kosovës po vazhdojnë me përgatitje për garat evropiane. Nga dita e diele kanë filluar dy herë në ditë, në mëngjes dhe mbrëmje nën udhëheqjen e trajnerit Rami Hadar. Atmosfera te "Dardanët" është shumë e mirë dhe lojtarët po japin maksimumin. Dominic Artis do të arrijë sonte vonë

dhe i bashkohet ekipit të hënën në stërvitje, kurse Mikaile Tmusiq ka munguar dy ditët e para me leje për arsye familjare. Ndërkohë, të dielën pasdite Musab Mala ka stërvitur veçmas, kurse Shëndrit Llapi, nuk ka stërvitur në mbrëmje, por të dy priten të jenë të gatshëm në ditët e ardhshme. "Dardanët" janë në grup me

Zvicrën dhe Danimarkën, në Rrethin e Tretë Parakualifikues për "Eurobasket 2025". Sfidat e parë për "Dardanët" është më 19 korrik në Prizren kundër Zvicrës. Më 26 korrik do të jenë mysafirë të Danimarkës dhe tri ditë më vonë ndaj Zvicrës. Përballja e fundit është ndaj Danimarkës më 5 gusht në Prizren.

Verstappeni fitoi garën e Çmimit të Madh të Austrisë

VJENË, 2 KORRIK - Piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappen, fitoi garën e Çmimit të Madh të Austrisë në Formula 1, suksesi i 7-të sezonal, i pesti radhazi, në një botë që po e dominon më shifra të frikshme. Kampioni i botës në fuqi e dominoi garën e zhvilluar në pistën e Seltweg, duke e lëshuar kreun vetëm për 10 xhiro, të cilin e rifitoi shumë kollaj. Në vendin e dytë u klasifikua monogasku Charles Leclerc me Ferrari, që bëri një garë të mirë, ashtu sikurse u paraqit makina

italiane në tërësi në këtë fundjavë. Në vendin e tretë u rendit mexikani Sergio Perez me makinën tjetër Red Bull, pozicion që e fitoi pas parakalimit të vështirë ndaj spanjollit Carlos Sainz (Ferrari) disa xhiro nga fundi. Makina virtuale e sigurisë në pjesën e parë të garës e bëri disi më interesante betejën për zonën e pikëve, pasi pilotët hynë në bokse për të ndërruar gomat e modifikuar strategjitë. Ndërkohë që sot ndikuan edhe penalitetet që komisarët e

garës dhanë për pilotët për tejklalimin e limiteve të pistës (mes tyre edhe Sainz e Hamilton). Kjo solli mjaft parakalime në pistë. Gjithsesi, Verstappen bëri një garë me vete, duke e dominuar botërorin e Formula 1, i pa shqetësuar nga rivalët. Ai bëri një ndalesë më shumë se rivalët për të marrë edhe pikën shtesë të xhiros së shpejtë dhe sërish nuk u arrit nga rivalët. Në zonën e pikëve u renditën Norris, Alonso, Hamilton, Russell, Gasly e Stroll.



Krasniqi: Jemi shumë të motivuar për Evropian



PRISHTINË, 2 KORRIK - Pivotja Arona Krasniqi është prej lojtareve të rëndësishme të Përfaqësues U19 të Kosovës që po përgatitet për Kampionatin Evropian që prej 8 deri më 16 korrik mbahet në Prishtinë. Arona është ende vetëm 16-vjeçare dhe llogaritet shpresë e hendbollit kosovar. Më herët këtë vit ajo kishte fituar rastin të ushtronte me Kombëtaren A, ndërsa tani është e grumbulluar me Kosovën U19. Pos që ndihet e privilegjuar,

Arona e di se përgjegjësia është më e madhe për faktin që Evropiani mbahet në Prishtinë. "Po vazhdojmë përgatitjet intensive për Kampionatin Evropian që do të mbahet në Prishtinë. Jemi të motivuara për këtë ngjarje të madhe sportive që do të mbahet në vendin tonë. Fakti se Evropiani mbahet te ne, do të jetë edhe një motiv shtesë. Presim përkrashje të tifozëve dhe hendbolldashësve", ka thënë Arona Krasniqi. Ajo e di që nuk

do të jetë lehtë në Evropianin e Divizionit B. "Shpresojmë se do të bëjmë më të mirën për Kombëtaren tonë. Jemi shumë të motivuara dhe paraqitja para tifozëve tanë na jep edhe më tepër përgjegjësi. Grupin nuk e kemi të lehtë, por natyrisht do të japim maksimumin", ka shtuar Arona. Ajo është falënderuese që fitoi rastin të ushtronte me lojtaret e Kombëtares së Kosovës. Përvojën e fituar në stërvitje me to do ta vë në shërbim të Kombëtares U19.

Augsburgun blen kartonin e Berishës

AUGSBURG, 2 KORRIK - FC Augsburg ka blerë përfundimisht shërbimet e Mergim Berishës nga Fenerbahçe. Klubi turk ka konfirmuar se sulmuesi 25-vjeçar ka nënshkruar

kontratë të përhershme me skuadrën e Bundesligës. Bëhet fjalë për një transferim, i cili nuk shkon më shumë se rreth 4 milionë euro. Megjithatë, ka shumë mundësi që Berisha të shitet

gjatë kësaj merkatoje, pasi lojtari dëshiron të luajë në ndonjë skuadër më të madhe. Megjithatë, deri më tani Augsburg nuk ka marrë ende një ofertë konkrete për sulmuesin, i cili shënoi

nëntë gola në 23 paraqitje sezonin e kaluar. 25-vjeçari ka luajtur 2 ndeshje për Kombëtaren e Gjermanisë, ndërsa numëron 13 paraqitje për Gjermaninë U21.





SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Zyrtar i ri për analiza buxhetore, kontroll dhe kontabilitet të shpenzimeve

Departamenti: Planifikim dhe Raportim Financiar

Divizioni: Mbikëqyrjes dhe Analizave (Buxheti dhe Kontrolli)

Grada: 7

Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit për Mbikëqyrje dhe Analiza

Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësie:

- Përgatit dhe rifreskon të dhënat (materialet) që kanë të bëjnë me buxhetin dhe kontabilitetin e shpenzimeve;
- Përgatit raportet ditore dhe periodike të shpenzimeve faktike për qëllime të kontabilitet të shpenzimeve (kostos) dhe analizave buxhetore përkatëse;
- Përgatitë paradhëniet për udhëtime zyrtare dhe përgatit dokumentacion për aprovimin e paradhënies dhe shpenzimeve për udhëtimet zyrtare në vend dhe jashtë vendit;
- Përkujdeset në implementimi i buxhetit sipas njësive shpenzuese /departamenteve, divizioneve/për shpenzimet e trajnimeve/studimeve dhe udhëtimeve zyrtare në bazë të politikave dhe procedurave të aprovuara për buxhet dhe kontabilitet të shpenzimeve (kostos);
- Përgatit raportet analizat e në lidhje me pikën paraprake në baza të rregullta ditore;
- Ndhmon në zhvillimin e sistemit të analizës buxhetor, në përputhje me kërkesat për shfrytëzimin e buxhetit dhe alternativat;
- Ndhmon në përgatitjen e rregullave dhe procedurave të punës dhe përgjegjësi në përputhje me përshkrimin e vendit të punës;
- Përgatitë analiza buxhetore lidhur me të hyrat dhe shpenzimet, për zërat specifik të tyre;
- Zëvendëson Zyrtarin e për Analiza Buxhetore dhe kontroll kur mungon duke realizuar detyrat ditore të tij/saj;
- Kryen punë tjera të ndërlidhura ashtu sipas kërkesave të mbikëqyrësit dhe vijës tjetër hierarkike.

Njohurit e kërkuara:

- Diploma e Universitetit në Ekonomi-ks, Financa, Kontabilitet apo Menaxhim Afarist;
- Preferohet të ketë përgatitje profesionale në kontabilitet (në shoqatat profesionale vendore dhe ndërkombëtare);
- Njohuri të mira të punëve bankare;
- Njohuri të mira në Excel dhe Word, si dhe preferohet të ketë përvojë pune me aplikacione (bankare) të kontabilitetit;
- Preferohet njohuri të mira të gjuhës angleze.

Përvoja e kërkuar:

- Preferohet 1 (një) vit përvojë pune në bankë/financa/buxhetim, kontabilitetin financiar dhe kontabilitetin e shpenzimeve.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **17 korrik 2023**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.



OBJAVA SLOBODNOG RADNOG MESTA

Pozicija: Mladi službenik za budžetske analize, kontrole i računovodstvo troškova

Odeljenje: Finansijsko planiranje i izveštavanje

Odsek: Nadzor i analize (budžet i kontrola)

Stepen: 7

Izveštava: Rukovodiocu Odseka za nadzor i analize

Pregled dužnosti i odgovornosti:

- Priprema i ažurira podatke (materijale) koji se odnose na budžet i računovodstvo troškova;
- Priprema dnevne i periodične izveštaje faktičkih troškova za potrebe računovodstva troškova (rashoda) i odgovarajućih budžetskih analiza;
- Priprema avanse za službena putovanja i priprema dokumentaciju za odobrenje avansa i troškova za službena putovanja u zemlji i inostranstvu;
- Vodi računa o izvršenju budžeta prema potrošačkim jedinicama/odeljenjima, odsecima/za troškove obuka/studija i službenih putovanja na osnovu politika i procedura odobrenih za budžet i računovodstvo troškova (rashoda);
- Priprema izveštaje i analize u vezi sa prethodnom tačkom na redovnim dnevnim osnovama;
- Pomaže u razvoju sistema budžetske analize, u skladu sa zahtevima za korišćenje budžeta i alternativama;
- Pomaže u pripremi pravila i procedura rada i odgovornosti u skladu sa opisom radnog mesta;
- Priprema budžetske analize vezano za prihode i rashode, za njihove specifične stavke;
- Menja službenika za budžetske analize i kontrolu u njegovom odsustvu tako što izvršava njegove dnevne zadatke;
- Obavlja i druge poslove na zahtev nadređenog i druge hijerarhijske linije.

Potrebna znanja:

- Univerzitetska diploma ekonomskog fakulteta, finansije, računovodstvo ili poslovno upravljanje;
- Poželjno je da ima stručnu spremu u računovodstvu (u domaćim i međunarodnim profesionalnim udruženjima);
- Dobro poznavanje bankarskih poslova;
- Dobro poznavanje rada na Excelu i Wordu, te je poželjno radno iskustvo sa (bankarskim) aplikacijama računovodstva;
- Poželjno je dobro poznavanje engleskog jezika.

Potrebno iskustvo:

- Poželjno je imati godinu dana radnog iskustva u bankama/finansijama/budžetiranju, finansijskom računovodstvu i računovodstvu troškova.

Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde se naglašava zainteresovanost za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo treba da budu priznate/nostrifikovane službeno od strane MONT-a;
- Potvrda o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

Postupak apliciranja:

- Poslednji rok za apliciranje je **17 jul 2023**.
- Apliciranje se može uraditi online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične stranice CBK ili preko arhive CBK. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti uzet u razmatranje.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti sa službene stranice: www.bqk-kos.org
- Nepotpuna dokumentacija neće biti razmotrena. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8, bazuar në Rregulloren Nr. 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e vendeve të punës në KMDK SH.A, bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe bazuar në Vendimin e UD Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK SH.A me Nr.85/2023 me nr. të protokolit 02-07/85, KMDK SH.A shpall(përsërit) këtë:

KONKURS PUBLIK (PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS)

Titulli:– Udhëheqës i Sektorit të Inxhinierisë I (Një) Pozitë

Numri i Referencës: ZP/KJ-7.2-2023

I raporton: Drejtorit të Operativës

Niveli i pagës: Niveli IV

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi

Vendi i punës: KMDK-së SH.A

Detyrat dhe Përgjegjësitë

- Planifikimet mujore dhe vjetore lidhur me konstruktimin e projekteve për investimet nëpër deponi;
- Harton përshkrimet teknike (me përmasa dhe llogari) të projekteve për rehabilitimin e infrastrukturës së DS dhe mbikëqyrë realizimin e punëve të kontraktuara me palët e treta;
- Planifikimet mujore dhe vjetore lidhur me konstruktimin dhe investimet nëpër deponi;
- Harton planet vjetore për nevojat furnizuese për të gjitha llojet e materialeve të cilat përdoren për infrastrukturën e Deponive Sanitare dhe Stacion të Transferit të cilat janë të nevojshme për operimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e Deponive dhe i dorëzohen tek Drejtori i Operativës;
- Përcjellë punën teknike në mirëmbajtje të të gjitha Deponive;
- Monitoron dhe menaxhon me zbatueshmërinë e projekteve kapitale nëpër Deponitë Sanitare dhe Stacion të Transferit;
- Jep këshilla dhe zgjedhje teknike për intervenime të domosdoshme në infrastrukturë, brenda deponive;
- Udhëheqësi i Sektorit të Inxhinierisë menaxhon me Njësinë Teknike dhe Njësinë e Mbrojtjes së Ambientit.
- Udhëheqësi i Sektorit të Inxhinierisë bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me Menaxheret e Deponive dhe Udhëheqësit e Njësive,
- Udhëheqësi i Sektorit të Inxhinierisë në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Drejtorin e Operativës, bashkërendon aktivitetet operative në Deponitë Sanitare dhe Stacion të Transferit,
- Përgatitë raportet sipas kërkesës së DO, mujore, vjetore etj;
- Udhëheqësi i Sektorit të Inxhinierisë për punën e vet i përgjigjet drejtpërdrejt Drejtorit të Operativës, sipas nevojës edhe Kryeshefit Ekzekutiv

Kualifikimet dhe përvoja e punës

- Diplomë Universitare, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës;
- Përvojë pune së paku 2 (dy) vite në fushën përkatëse;

Aftësitë kryesore

- Shkathhtësitë të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, janë të nevojshme programet (Autocad, Archicad, Windows, Outlook, Microsoft Office dhe programe të llogaritjes së strukturës së stabilitetit etj.);
- Kapacitet për punë ekipore;
- Aftësi të mira komunikimi, me palët e interesit;
- Preferohet njohja e gjuhës angleze në të folur dhe të shkruar.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrë e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në zyrë e Burimeve Njerëzore në adresën: Rruga “Bekim Fehmiu” Nr. 137, 10000 Prishtinë, Kosovë (Afër Shkollës Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Tel: 038/ 600 – 552.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Aplikacioni
- CV,
- Diploma,
- Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet,
- Dëshmi mbi përvojën në punë, si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe aftësive.
- Certifikatë nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i/e dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit)

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit të Konkursit të Jashtëm në Gazetat/Platformat Elektronike dhe Web-Faqe të KMDK-së, duke filluar nga data: 03.07.2023 deri me datën 17.07.2023 ora 08:00-16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Zyren e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A.

Email: info@kmdk-ks.org

Tel: 038/ 600 – 552.



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE SKLADIŠTIMA NA KOSOVU dd

Na osnovu Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, Zakon br. 03/L-212 o radu, konkretno član 8, na osnovu Uredbe br. 23/2020 o postupku zapošljavanja, organizacionoj strukturi, kategorizaciji i opisu poslova u KMDK S.A., na osnovu Administrativnog uputstva (MPMS) br. 07/2017 o Pravilniku o konkursu u javnom sektoru i na osnovu Odluke UD načelniku Izvršni službenik KMDK SHA sa br. 85/2023 sa br. protokola 02-07/85 KMDK dd saopštava (ponavlja) ovo:

JAVNI KONKURS (ZA POPUNJAVANJE RADNOG MJESTA)

Zvanje: - Rukovodilac sektora inženjeringa 1 (jedna) pozicija

Referentni broj: ZP/KJ-7.2-2023

Izveštava: Direktor operacija

Nivo plata: Nivo IV

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje ugovora: Na određeno (1 godina) sa mogućnošću produženja

Mjesto rada: KMDK dd

Dužnosti i odgovornosti

- Mjesečno i godišnje planiranje vezano za izgradnju projekata za ulaganja u deponije;
- Izrađuje tehničke opise (sa dimenzijama i proračunima) projekata sanacije infrastrukture DS i vrši nadzor nad izvođenjem radova ugovorenih sa trećim licima;
- Mjesečno i godišnje planiranje izgradnje i ulaganja u deponije;
- Izrađuje godišnje planove potreba za snabdijevanjem svih vrsta materijala koji se koriste za infrastrukturu sanitarnih deponija i transfer stanica neophodnih za rad, održavanje i rad deponija i dostavlja ih direktoru operacija;
- Izvodi tehničke poslove na održavanju svih deponija;
- Prati i upravlja primjenjivošću kapitalnih projekata na sanitarnim deponijama i transfer stanicama,
- Daje savjete i tehničke izbore za neophodne intervencije na infrastrukturi, unutar deponija;
- Rukovodilac Sektora inženjeringa rukovodi sa Tehničkom jedinicom i Jedinicom za zaštitu životne sredine.
- Rukovodilac sektora inženjeringa saraduje i koordinira aktivnosti sa menadžerima skladišta i rukovodiocima jedinica,
- Rukovodilac sektora inženjeringa u direktnoj saradnji sa direktorom operacija koordinira operativnim aktivnostima na sanitarnim deponijama i transfer stanic,
- Izrada izvještaja prema zahtjevu DO, mjesečne, godišnje i sl.;
- Načelnik sektora za inženjering za svoj rad odgovara direktno direktoru operacija, a po potrebi i glavnom izvršnom direktoru

Kvalifikacije i radno iskustvo

- VSS, Građevinsko-arhitektonski fakultet;
- Radno iskustvo od najmanje 2 (dvije) godine u relevantnoj oblasti;

Ključne vještine

- Odlično poznavanje rada na računaru, neophodni su programi (Autocad, Archicad, Windows, Outlook, Microsoft Office i programi za proračun strukture stabilnosti itd.);
- Kapaciteti za timski rad;
- Dobre komunikacijske vještine sa zainteresovanim stranama;
- Poželjno je poznavanje govornog i pisanog engleskog jezika.

Konkursna procedura

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvanični formular u kancelariji za ljudske resurse KMDK SH.A ili ga preuzeti sa web stranice na adresi: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji kancelariji za ljudske resurse na adresi: ulica „Bekim Fehmiu“ br. 137, 10000 Prishtina, Kosovo (blizu škole Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Telefon: 038/ 600 – 552.

Kandidati koji se takmiče moraju ispravno unijeti adresu, kontakt telefon i email adresu. Samo odabrani kandidati će biti pozvani na dalje procedure zapošljavanja.

Potrebna dokumentacija:

- Aplikacija
- Životopis,
- Diploma,
- certifikate o kvalifikacijama i obuci,
- Dokaz o radnom iskustvu, kao i drugi dokazi na osnovu kvalifikacija i vještina.
- Uvjerenje nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da nije osuđivan za neko krivično djelo (ne starije od 6 (šest) mjeseci od dana izdavanja)

Napomena: Prijave poslate poštom, koje su obilježene poštanskim žigom posljednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se valjanim i bit će uzete u obzir ako stignu u roku od tri (3) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one koje nisu kompletirane sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja Eksternog konkursa u novinama/elektronskim platformama i web stranicama KMDK, počev od: 03.07.2023. do 17.07.2023. godine, 08:00-16:00 časova.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Službi za ljudske resurse KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Telefon: 038/ 600 – 552.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

